



Komuna e Klinës

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport

10 Nr. 111-34600/175

Klinë, dt.14.10.2025

Duke u mbështetur në Vendimin e Asamblesë Komunale për ndarje të Çmimit Vjetor të Artit Figurativ "ART KLINA", të dt.27.03.2015, Nr.06-2588/2015 si dhe në Rregulloren për mbajtjen e simboleve komunale, procedurën, mënyrën dhe kushtet për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe shpërblime tjera, Nr.01-06-4414/2015 e datës 20.07.2015, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport shpall:

KONKURS

PËR ÇMIMIN "ART KLINA" – 2025, edicioni i X-të (dhjetë)

Të drejtë konkurrimi kanë të gjithë krijuesit e artit figurativ profesional me nga një punim të realizuar në teknikat: *vizatim, grafikë, pikturë, skulpturë dhe fotografi artistike*.

- Afati i dorëzimit të punimeve është nga dita e shpalljes së konkursit, pra nga data 14.10.2025 deri më 14.11.2025 (e premte, ora 16:00).

- Bashkë me punime, autorët duhet të dorëzojnë titullin e veprës, teknika, dimensionet dhe vitin e realizimit të veprës.

- Punimet konkurruese duhet të jenë të përgatitura teknikisht dhe të kornizuara.

- Punimet e pranuar nga juria do të ekspozohen në Galerinë e Qendrës së Kulturës "Jehona e Dukagjinit" për nder të festës së 28 Nëntorit, hapja solemne e ekspozitës do të bëhet më datën 26.11.2025 (e mërkure), ora 14:00.

- Juria profesionale me këtë rast, në hapjen solemne të ekspozitës vlerëson dhe jep çmimin "ART KLINA" – 2025 sipas përcaktimit në vijim:

1. Çmimi kryesor "Art Klina" - 300 €

2. Vendi dytë - 100 €

3. Vendi tretë - 100 €

- Punimet fizike duhet të dorëzohen në Qendrën e Kulturës "Jehona e Dukagjinit" - Klinë, të zyrtarët për kulturë:

• Taulant Berisha nr. 049 840 173, e-mail: taulant.berisha@rks-gov.net dhe

Alban Gashi nr. 044 317 091, e-mail: alban.gashi@rks-gov.net

Driton Bardheci

Drejtor për Kulturë, Rini dhe Sport